



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKË SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Datë 05/08/2020

Nga: Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndrëçimit Publik, Tiranë.

Drejtuar: Shoqërisë “AMOS OIL” sha me NUIS K87508801F me adresë: Lagjia 5 Shkurti, Pranë Karburant Neri, Përballë Bashkisë, Ballsh.

Procedura e prokurimit: Procedurë e Hapur.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-61485-06-16-2020.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje prajmer dhe materiale ndihmëse për asfaltin” afati: Nga nënshkrimi i kontratës deri me 31.12.2020 sipas nevojave dhe kërkesave të Autoritetit Kontrator.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 37, Date 22.06.2020.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara si më poshtë:

1. Operatori ekonomik “AMOS OIL” sha me NUIS K87508801F me ofertë ekonomike **9.646.000** (nëntë milion e gjashtëqind e dyzetë e gjashtë mijë) lekë pa tvsh.
2. Operatori ekonomik “BIBA-X” shpk me NUIS K32618815N me ofertë ekonomike **8.108.000** (tetë milion e njëqind e tetë mijë) lekë pa tvsh.
3. Operatori ekonomik “NERI” shpk me NUIS J78423806C me ofertë ekonomike **9.853.000** (nëntë milion e tetëqind e pesëdhjet e tre mijë) leke pa tvsh.
4. Operatori ekonomik “S I R E T A 2F” shpk me NUIS K51501008J me ofertë ekonomike **8.504.500** (tetë milion e pesëqindë e katër mijë e pesëqindë) lekë pa tvsh.
5. Operatori ekonomik “SARK” shpk me NUIS K52531415H me ofertë ekonomike **8.601.193** (tetë milion e gjashtëqind e një mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. “BIBA-X” shpk me NUIS K32618815N.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Nuk përmbush pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik ku parashikohet se: *“Operatori duhet të dorëzojë:*

Furnizime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, në vlerën prej jo më pak se 40% e fondit limit të vënë në dispozicion përkatësisht: 4.068.800 (katër milion e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) lekë pa TVSH.

Këto furnizime të ngjashme do të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate dhe faturat me tvsh.

OSE

- b. Kur furnizim i ngjashëm është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur fatura tatimore shitje, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”

Operatori ekonomik “BIBA –X” sh.p.k ka paraqitur kontratën me Nr.732/2 Prot., datë 25.02.2019 me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës Synej-Bago” lidhur me Bashkinë Kavajë. Në situacionin përfundimtar të punimeve rezulton që operatori ka kryer punime në rrugë të ndarë në dy zëra si mëposhtë:

Zëri i parë: - Shtesë binderi me zall lavatriçe (mbushje gjatë gjithë gjatësisë së rrugës)

Zëri i dytë: - Shtresë asfaltobeton zall lavatriçe 4 cm me makinë

Duke u nisur nga ky situacion, punimet e mësipërme nuk mund të konsiderohen të ngjashme me objektin e prokurimit që është furnizim me prajmer.

- Nuk përmbush pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik ku parashikohet se: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim Prodhuesi ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi, për mallin objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.”*

Operatori ekonomik “BIBA –X” sh.p.k ka paraqitur një deklaratë ku shprehet se ka në pronësi impiant prodhimi emulsion bituminoz dhe e prodhon vetë prajmerin.

Në objektin e aktivitetit të operatorit ekonomik sipas Ekstraktit të lëshuar nga QKB-ja, më datë 02.07.2020 nuk rezulton që ky operator të kryejë aktivitet prodhimi të mallit objekt prokurimi apo të çfarëdo lloj prodhimi tjetër.

Në lejen mjedisore të tipit B, me kod III.1.B lëshuar subjektit “BIBA-X” në rubrikën ku përshkruhet veprimtaria e kryer nuk rezulton të lejohet veprimtari prodhimi të mallit objekt prokurimi.

Në këto kushte, operatori ekonomik nuk mund të konsiderohet prodhues për mallin objekt prokurimi.

Përsa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914,

datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), **e shpall të pavlefshme këtë ofertë**, pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. “NERI” shpk me NUIS J78423806C.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Nuk përmbush asnjë pikë të kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e këtyre pikave, përveç Formularit të Ofertës Ekonomike.

3. “S I R E T A 2F” shpk me NUIS K51501008J.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Nuk plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim pasi operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për plotësimin e kriterëve të përgjithshme për kualifikim të kërkuara në DST nga Autoriteti Kontraktor.
- Nuk plotëson kriteret e veçanta për kualifikim pasi operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për plotësimin e kriterëve të veçanta për kualifikim të kërkuara në DST nga Autoriteti Kontraktor.

4. “SARK” shpk me NUIS K52531415H.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Nuk përmbush pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik ku parashikohet se: *“Operatori duhet të dorëzojë:*

Furnizime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, në vlerën prej jo më pak se 40% e fondit limit të vënë në dispozicion përkatësisht: 4.068.800 (katër milion e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) lekë pa TVSH. Këto furnizime të ngjashme do të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate dhe faturat me tvsh.

OSE

- b. Kur furnizim i ngjashëm është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur fatura tatimore shitje, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”

- Operatori ekonomik “Sark” sh.p.k ka paraqitur disa fatura tatimore shitje me objekt shitje çakull dhe materiale inerte të ndryshme të cilat nuk konsiderohen furnizime të ngjashme me mallin objekt prokurimi.

- Në faturën tatimore të shitjes me Nr. 100, datë 30.07.2019 lëshuar për subjektin Bashkia Divjakë shoqëruar me situacionin përkatës rezulton zëri Emulsion Bitumi me vlerë 413 190 pa tvsh, vlerë e cila është më e ulët se vlera prej 4.068.800 (katër milion e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) lekë pa TVSH.

Nga analiza e mësipërme rezulton se operatori ekonomik nuk plotëson kriterin e kontratave të ngjashme.

- Nuk përmbush pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik ku parashikohet se *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, në orën e përcaktuar për hapjen e ofertave në dokumentat e*

tenderit, mostrën e prajmerit (1 kuti prej 15 kg ose 20 kg). Mosparaqitja e mostrës përbën shkak për skualifikim.”

Nga verifikimi i mostrës së paraqitur pranë AK në datën dhe orën e hapjes së ofertave rezulton se mostra është e një prodhuesi të ndryshëm nga ai për të cilin OE ka paraqitur autorizim prodhuesi dhe fletë analizën. Sqarojmë se mostra e paraqitur rezulton e subjektit MAT-EDIL sh.p.k ndërsa dokumentacioni teknik për të cilin ka paraqitur autorizim prodhuesi dhe fletë analiza, rezulton e subjektit RESULI-ER sh.p.k, duke sjellë mospërputhje midis mostrës dhe dokumentacionit të paraqitur.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **“AMOS OIL” sha me NUIS K87508801F** me adresë Lagjia 5 Shkurti, Pranë Karburant Neri, Përballë Bashkisë, Ballsh, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej: **9.646.000** (nëntë milion e gjashtëqind e dyzetë e gjashtë mijë) lekë pa TVSH, **është identifikuar si ofertë e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Rruga 5 Maji, sigurimin e kontratës siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve që nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë 28.07.2020.

Ankesa: Nuk ka.